



Republika e Kosovës/ Republika Kosovo/ Republic of  
Kosovo  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački savet Kosova/  
Kosovo Prosecutorial Council



Republika e Kosovës/ Republika Kosovo/ Republic of  
Kosovo  
Prokurori i Shtetit/ Džavni Tužilac/ State Prosecutor

# STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM E SISTEMIT PROKURORIAL

2024-2026

## **Përmbajtja**

|  |    |
|--|----|
| MISSIONI .....   | 4  |
| VIZIONI .....  | 4  |
| METODOLOGJIA .....   | 5  |
| OBJEKTIVAT .....   | 9  |
| OBJEKTIVA I - NGRITJA E TRANSPARENÇES NË SISTEMIN PROKURORIAL TË KOSOVËS .....                                     | 9  |
| a) Ngritja e transparencës përmes publikimeve të vazhdueshme: .....  | 10 |
| b) Komunikimi Proaktiv: .....  | 10 |
| c) Koordinimi ndërinstitucional në fushën e komunikimit: .....   | 11 |
| OBJEKTIVA II - FUQIZIMI I KOMUNIKIMIT TË BRENDSHËM .....   | 11 |
| a) Koordinimi i komunikimit të brendshëm të njërive për komunikim me anë të: .....                                 | 12 |
| b) Koordinimi i komunikimit të brendshëm të njërive për komunikim me njësitë e tjera organizative me anë të: ..... | 12 |
| OBJEKTIVA III - AVANCIMI I BASHKËPUNIMIT ME MEDIA, SHOQËRINË CIVILE DHE ORGANIZATAT E TJERA .....                  | 12 |
| PLANI I VEPRIMIT .....   | 15 |

## HVRJE

Strategjia për komunikim është ne harmoni te plote me planin strategjik te sistemit prokurorial dhe një vazhdimësi e srynimit për të përmirësuar cilësinë e komunikimit të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës, duke adresuar disa elemente kyçe të përfshira në planifikimin e të dhënave të brendshme dhe të jashtme. Srynimi i kësaj strategjie te sistemit prokurorial është të inkurajojë pjesëmarrjen dhe informimin e qytetarëve, të rrisë përgjegjshmërinë dhe transparencën ndaj opinionit të gjerë publik dhe të thellojë bashkëpunimin me mediat për të siguruar një informim të shpejtë dhe të saktë lidhur me punën e prokurorive.

Kjo strategji merr parasysh edhe qasjet e reja të komunikimit duke përfshirë elemente të tilla si interaktiviteti, aktiviteti dhe proaktiviteti. Është një pajtueshmëri e përgjithshme që sistemi prokurorial synon të jetë një institucion i hapur që përgjigjet ndaj pyetjeve të gazetarëve, ndërkohë që gjithashtu nxit vetëdijësimin në lidhje me punën e tij. Gjithashtu, një aspekt i rëndësishëm i kësaj strategjie është vlerësimi i opinionit të aktorëve të ndryshëm, duke i bërë ata pjesë të procesit të komunikimit.

Në përputhje me kohën dhe zhvillimin e teknologjisë, ky plan i komunikimit përfshin edhe përdorimin e rrejteteve sociale si një risi thelbësore. Rrejtete sociale si Facebook dhe Youtube do të shfrytëzohen për të shpërndarë informacione relevante, njoftime për raste specifike, dhe për të përgjigjur pyetjeve të qytetarëve. Përmes rrejteteve sociale, sistemi prokurorial synon të ndërtojë një lidhje të drejtpërdrejtë dhe transparente me publikun, duke i bërë ato një kanal të fuqishëm për komunikim të dyanshëm dhe për të përcjellë mesazhet kyçe.

Strategjia e komunikimit përgendrohet në përmirësimin e qasjes ndaj publikut dhe krijimin e një dialogu të vazhdueshëm me qytetarët dhe median. Përmes kësaj strategjie, sistemi prokurorial synon të bëhet më transparent, më i qartë dhe më afër me nevojat dhe pritjet e shoqërisë

## **MISIONI**

Të avancojë transparencën, të ngritë nivelin e besueshmërisë në punën e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës dhe të kontribuojë në vetëdijësimin e qytetarëve mbi punën e sistemit prokurorial.

## **VIZIONI**

Sistemi prokurorial mbetet i angazhuar të fuqizojë mekanizma të qëndrueshëm të komunikimit më efikas dhe efektiv me qellim të informimit të drejtë dhe të saktë për punën e përditshme e cila është në interes të publikut.

## **GJENDJA AKTUALE**

Sistemi prokurorial i Republikës së Kosovës ballafaqohet me një varg sfidaash të ndryshme, të cilat ndikojnë në marrëdhënien e tij me publikun, duke kërkuar një avancim të përhershëm të komunikimit.

Sfidat e vazhdueshme përfshijnë rritjen e numrit të mediave dhe gazetarëve dhe mungesa e profilizimit të tyre në fushën e drejtësisë. Gazetarët në të shumtën e rasteve nuk janë të specializuar për të mbuluar një fushë specifike si fushë veprimi i prokurorisë. Sido që të jetë kjo situatë me një numër të madh të mediave, paraqet një mundësi për të forcuar informimin dhe vetëdijësimin e publikut lidhur me funksionimin dhe rolin e prokurorisë duke bashkëpunuar me mediet në ngritjen e cilësisë së raportimit përmes kuptimit të punës dhe fushë veprimi të prokurorisë

Një tjetër sfidë është aspekti financiar dhe nevoja për ndërtimin e një kulture të brendshme të komunikimit mes punonjësve brenda sistemit. Për të arritur qëllimet e përbashkëta, është e nevojshme një gatishmëri e rritur për bashkëpunimin dhe koordinimin të aktiviteteve të prokurorëve dhe stafit mbështetës, duke përfshirë zyrat për komunikim publik.

Kompletimi me staf të mjaftueshëm dhe përmirësimi i kushteve pune për njësitë e komunikimit janë sfida të tjera që kërkojnë veprime të menjëhershme. Po ashtu, krijimi dhe zbatimi i dokumenteve dhe akteve strategjike janë domosdoshmëri për të rregulluar komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm, duke përfshirë marrëveshjet për komunikim me media dhe shoqërinë civile.

Strategjia e re e paraparë për tre vjetët e ardhshëm (2024-2026) ka tri objektiva që synojnë të bëjnë sistemin prokurorioral më të afërt me audiencën dhe të risin besimin e qytetarëve. Për këtë qëllim, aktivitetet e planifikuara synojnë të ndërtojnë një mekanizëm partneriteti me mediat, duke theksuar transparencën dhe hapësirën për dialog. Këto hapa synojnë të thellojnë lidhjen pozitive me publikun dhe të përmirësojnë imazhin e sistemit prokurorioral në sytë e opinionit publik.

## METODOLOGJIA

Strategjia e Komunikimit 2024-2026 është hartuar nëpërmjet një procesi tërësisht përfshirës, duke përfshirë të gjithë aktorët kyçë të përfshirë në zbatimin e saj. Kjo ka përfshirë përfaqësues të sistemit prokurorioral, organizata ndërkombëtare si Zyrën e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), përfaqësues nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovë (AGK) dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Pjesëmarrja e këtyre aktorëve ka siguruar një perspektivë të pasur dhe të përgjegjshme në hartimin e kësaj strategjise.

Në procesin e hartimit të kësaj strategjie, fillimisht është shqyrtuar strategjia e komunikimit 2021-2023 (Aneksi 1), pastaj është kryer një shqyrtim i hollësishtëm i të gjitha raporteve vlerësuese dhe dokumenteve të tjera që lidhen me zbatimin e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm të sistemit prokurorioral. Këtu përfshihen aktet e brendshme nënligjore dhe ligjet aktuale në fuqi në Republikën e Kosovës që kanë lidhje me këtë gëshje.

Një pjesë e rëndësishme e këtij procesi ka qenë analiza e zbatimit të strategjisë së mëparshme për periudhën 2021-2023. Kjo analizë ka shqyrtuar me kujdes efektivitetin dhe ndikimin e aktiviteteve të ndërmarra në strategjinë e mëparshme, duke identifikuar ato që kanë funksionuar me sukses dhe ato që kanë pasuar me sfida. Ky vlerësim ka shërbyer si bazë për riformulimin e dispozitave dhe aktiviteteve të reja dhe përmirësimin e fushave që kanë nevojë për avancim dhe përshatje.

Përgjatë këtij procesi, ka pasuar një konsultim aktiv me pjesëmarrësit e të gjithë niveleve të interesit për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe për të përdorur përvojën dhe vlerësimet e secilit prej tyre në hartimin e një strategjie të avancuar dhe efektive.

## **KORNIZA LIGJORE**

Strategjia në përmbajtjen e saj është brenda kornizës ligjore dhe nënligjore që rregullon funksionimin e sistemit prokurorial, sistemit e drejtësisë në përgjithësi, të drejtën e opinionit për t'u informuar si dhe të drejtat dhe privatësinë e të gjitha palëve në procedurat penale.

Përveç kornizës ligjore që do të paraqitet më poshtë, kjo strategji ka marrë parasysh dhe do të respektojë të gjitha konventat ndërkombëtare, mosrespektimi i të cilave automatikisht shkakton pasoja juridike në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Korniza ligjore, në të cilën është mbështetur kjo strategji është:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, nr. 08/1-032;
- Ligji nr. 08/L-187 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 08/1-032 të procedurës penale
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06/1-074;
- Ligji nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 06/1-074 penal te Kosovës

- Kodi i Drejtësisë për të Mitur, nr. 06/1-006;
- Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nr. 06/1-056;
- Ligji për Prokurorin e Shtetit, nr.08/L-167 ;
- Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, nr. 08/L-168;
- Ligji për Mbrojtjen e Sigjalozuesve, nr. 06/1-085;
- Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, nr. 04/-1-015;
- Ligji për Ndërmjetësim, nr. 06/1-009;
- Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, nr. 08/L-108;
- Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. 06/1-011;
- Ligji për Përdorimin e Gjyheve, nr. 02/1-37
- Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, nr. 04/1- 231;
- Rregullore për Klasifikimin e Informacioneve të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, nr.04/2017;
- Rregullorja për Shërbimin e Komunikimit Publik në Sistemin Prokurorial, nr.03.2019;
- Rregullorja për Njësinë Ndërlidhëse për Përgjime, nr. 05.2016;
- Rregullorja për Bashkëpunim Institucional, nr.04.2016;
- Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Funkcionimin e Prokurorit të Shtetit, nr.05.2023;
- Rregullorja për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës, nr.02.2020;
- Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në Këshillit Prokurorial të Kosovës, nr. 02/2023
- Rregullorja për Komisionin për Administrimin e Prokurorive, nr.03/2017;
- Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorët;
- Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
- Kodin e Etikës Profesionale për Punonjësit Mbështetës.

## KUFIZIMET LIGJORE

Kjo strategji dhe aktivitetet e saj do të nënshtrohen kufizimeve ligjore në raste kur ka kërkesa për informacione të mbrojtura nga ligji dhe akte nënligjore. Kufizimet do të aplikohen edhe në situatat kur disa informacione mund të dëmtojnë hetimet, shkelin të drejtat dhe liritë e njeriut, apo cenojnë sigurinë kombëtare. Gjithashtu, do të mbrohet e drejta e gazetarëve për të përdorur dhe për të mbrojtur burimet anonime të informacionit, me përjashtim të rasteve kur ligji ndryshe e parashikon.

Në çdo rast, do të ruhet ekuilibri midis të drejtës së opinionit për të marrë informata në kohën e duhur dhe nevojës për të mbrojtur hetime konkrete dhe të drejtat e palëve në procedurat penale. Prioritet do të jepet informimit të publikut në raste me interes të veçantë, pa kërçenuar hetime të ndjeshme dhe të drejtat e pjesëmarrësve në procedurë penale.

Transparenca do të mbahet në krye të aktiviteteve informuese, duke respektuar gjithmonë interesin e publikut dhe duke u përpiqur të ruhet një procedurë penale e drejtë dhe e ndershme. Ligjet dhe aktet juridike që rregullojnë sistemin prokurorial, sistemin gjyqësor, dhe të drejtat e palëve në procedurat penale do të respektohen në çdo rast. Gjatë informimit të publikut, do të konsiderohet ekuilibri midis transparencës dhe mbrojtjes së interesit të hetimit. Informacionet do të shpërndahen ku është e mundur dhe mbahen ku është e nevojshme, duke u kujdesur që të ruhet gjithmonë balanca midis interesit të publikut, interesit të hetimeve, dhe të drejtave të palëve në procedurë penale.

## LISTA E SHKURTESAVE

|           |   |
|-----------|---|
| KPK.....  | Këshilli Prokurorial i Kosovës;                 |
| PSH.....  | Prokurori i Shtetit;                            |
| SKPC..... | Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës |
| BE.....   | Bashkimi Evropian                               |
| ShBA..... | Shtetet e Bashkuara të Amerikës                 |
| AGK.....  | Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës             |



## **OBJEKTIVAT**

Brenda kornizës së kësaj strategjie, janë formuluar tri objektiva specifike, të cilat synojnë të arrihen përmes një sërë aktivitetesh konkrete, të përcaktuara sipas planit të veprimit dhe afateve kohore të parapara. Implementimi i këtyre aktiviteteve do të varet nga një bashkëpunim i ngushtë i brendshëm, koordinimi i veprimeve me institucionet e tjera relevante, përcaktimi i kostos financiare dhe sigurimi i mbulimit buxhetor për to.

### **OBJEKTIVA I - NGRITJA E TRANSPARENÇËS NË SISTEMIN PROKURORIAL TË KOSOVËS**

Sistemi prokurorial i Kosovës ka shënuar përparim të rëndësishëm në ngritjen e transparencës gjate zbatimit te strategjisë së mëparshme të komunikimit. Megjithatë, objektivi për ngritjen e transparencës vazhdon të jetë një sfidë konstante dhe kërkon një qasje proaktive në shtirje të aktiviteteve që paragesin institucionin si një entitet transparent. Për të arritur këtë, është e nevojshme të vazhdohet me hartimin dhe zbatimin e politikave të reja, siç parashikohet në këtë strategji.

Komunikimi proaktiv i sistemit prokurorial me publikun luan një rol kyç në këtë përpjekje. Përmes komunikimit proaktiv, sistemi prokurorial mund të prezantojë në mënyrë aktive informacione dhe zhvillime të rëndësishme që lidhen me punën e tij. Kjo sjellje aktive dhe paraprake mund të ndihmojë në ndërtimin e një imazhi pozitiv dhe të besueshëm në sytë e qytetarëve. Nëpërmjet komunikimit proaktiv, sistemi prokurorial mund të informojë qytetarët për mënyrën e funksionimit të tij, hapat e ndërmarrja për të përmirësuar efikasitetin dhe përgjegjshmërinë, si dhe të ndihmojë në ndërtimin e një lidhje të fortë me publikun.

Rëndësia e komunikimit proaktiv nuk është vetëm në shënimin e sukseseve dhe arritjeve, por edhe në adresimin proaktiv të çështjeve të mundshme, duke zbuluar transparencën edhe në momente sfiduese. Ky lloj komunikimi krijon një lidhje të fortë me qytetarët, duke i bërë ata pjesë të procesit dhe duke rritur besimin e tyre në institucionin prokurorial. Për këtë arsye, implementimi i komunikimit proaktiv duhet të jetë një nga pikat kryesore në zbatimin e kësaj strategjie.

Ky objektiv ka tri nën-objektiva që synohet të përmbushen përmes aktiviteteve të parapara si në vijim:

**a) Ngritja e transparencës përmes publikimeve të vazhdueshme:**

- ❖ Publikimi i raportit 24-orësh;
- ❖ Publikimi i raportit në rrjetin social;
- ❖ Publikimi i buletineve të sistemit prokurorial;
- ❖ Realizimi i fushatave vetëdijuese për rolin, misionin dhe veprimtarinë e sistemit prokurorial;
- ❖ Organizimi i konferencave për media;
- ❖ Rritje e paraqitjeve në media nga udhëheqësit e sistemit prokurorial;
- ❖ Mblajtja e takimeve me qytetarë;
- ❖ Lansimi, promovimi dhe mirëmbajtja e ueb faqes së re të sistemit prokurorial;
- ❖ Avancimi si nga përmbajtja dhe nga ana vizuale e publikimeve;
- ❖ Vetëdijësimi mbi të drejtën në qasje në dokumente publike.

**b) Komunikimi Proaktiv:**

- ❖ Ngritja e kapaciteteve të komunikimit brenda sistemit prokurorial;
- ❖ Veprimi dhe reagimi në kohë;
- ❖ Unifikimi i standardeve të komunikimit në sistemin prokurorial;
- ❖ Avancimi i informimit të rregullt të kryeprokurorëve dhe prokurorëve lidhur me ngjarjet ditore për fushë veprimtarinë e sistemit prokurorial;
- ❖ Komunikimi efikas dhe efektiv në raste specifike;
- ❖ Komunikimi përmes rrjeteve sociale;
- ❖ Hartimi i udhëzuesve në fushën e komunikimit dhe përdorimit të mediave sociale;
- ❖ Takime vjetore mes gazetarëve dhe Prokurorit Koordinator për rastet e gazetarëve.

- c) **Koordinimi ndërinstitutional në fushën e komunikimit:**
- ❖ Mbatja e takimeve me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera;
  - ❖ Formimi i ekipit të përbashkët (të sigurisë dhe drejtësisë) për komunikim ndërinstitutional;
  - ❖ Lidhja e memorandumëve me institucionet e tjera dhe partnerët;
  - ❖ Mbatja e konferencave të përbashkëta me Policinë e Kosovës dhe institucionet e të tjera zbatuese të Ligjit;
  - ❖ Organizimi i trajnimeve dhe aktivitetëve me institucionet zbatuese të ligjit;
  - ❖ Avancimi i pozitës së zyrtarit të komunikimit në nivele menaxherial / rritja e resurseve të brendshme.

## **OBJEKTIVA II - FUQIZIMI I KOMUNIKIMIT TË BRENDSHËM**

Sistemi prokurorial e njeherë kritikë të komunikimit të brendshëm dhe e zbaton atë si një pjesë të rëndësishme të strategjisë së tij. Duke u përqendruar në lidhjen e ngushtë midis efektshmërisë së sistemit prokurorial dhe përmirësimit të imazhit të institucionit në sytë e publikut, kemi vlerësuar rritjen e nevojshme për koordinim, komunikim dhe veprimtari të reja si elemente themelore për një avancim të suksesshëm të komunikimit brendshëm.

Kjo strategji synon të bëjë komunikimin e brendshëm të sistemit prokurorial një proces të vazhdueshëm, i planifikuar me kohë dhe që i paraprin proceseve të punës. Një nga qëllimet kyçe është përmirësimi i efektivitetit të komunikimit të brendshëm në mënyrë që të krijohet një lidhje të qëndrueshme midis komunikimit të brendshëm dhe atij të jashtëm.

Qëllimi për fuqizimin e komunikimit të brendshëm gjithashtu përkon me objektivin kryesor të sistemit prokurorial, i cili është ndërtimi i një kulture afatgjatë organizative, duke përfshirë praktikën që promovojnë koordinimin sa më të mirë të komunikimit të brendshëm. Ky synim ka një impakt të drejtpërdrejtë në efikasitetin e detyrave dhe përgjegjësi të institucionit, si dhe në sigurimin e një komunikimi të jashtëm me informacion të plotë dhe të saktë.

Në këtë mënyrë, fuqizimi i komunikimit të brendshëm jo vetëm që përmbush një nevojë të brendshme organizative, por gjithashtu ka një ndikim pozitiv në rritjen e transparencës dhe besimit tek qytetarët. Një komunikim i fortë dhe i koordinuar brenda institucionit krijon një ambient ku transparencë dhe përgjegjshmëria janë në qendër, duke ndihmuar në ndërtimin e një lidhje të fortë dhe të besueshme me publikun.

Kjo objektiv ka dy nën-objektiva, të cilat synohen të arrihen përmes aktiviteteve si në vijim:

- a) **Koordinimi i komunikimit të brendshëm të njërive për komunikim me anë të:**
  - ❖ Takimeve të rregullta mujore mes zyrtareve për komunikim të sistemit prokurorial për çështje koordinimi;
  - ❖ Takimeve mes zëdhënësve të sistemit prokurorial dhe kryeprokuroreve për çështje koordinimi;
  - ❖ Krijimin e kalendareve të përbashkët brenda sistemit për aktivitetet komunikuese;
  - ❖ Rishikim dhe përmirësimin e proceseve të komunikimit të brendshëm.
- b) **Koordinimi i komunikimit të brendshëm të njërive për komunikim me njësitë e tjera organizative me anë të:**
  - ❖ Koordinimi i komunikimit ndërmjet njërive të KPK-së;
  - ❖ Koordinimi i komunikimit ndërmjet njërive të ZKPSH-së;
  - ❖ Koordinimi i komunikimit ndërmjet njërive të prokurorive;
  - ❖ Koordinimi i komunikimit ndërmjet të gjitha njërive organizative të sistemit prokurorial.

### **OBJEKTIVA III - AVANCIMI I BASHKËPUNIMIT ME MEDIA, SHOQËRINË CIVILE DHE ORGANIZATAT E TJERA**

Ky objektiv ka rëndësi të veçantë për fuqizimin dhe ngritjen e komunikimit të jashtëm, ngritjen e transparencës dhe besueshmërisë në sistemin prokurorial të Kosovës dhe avancimin shumëdimensional të komunikimit të jashtëm, sepse lidhet me bashkëpunimin, i cili ka një fokus shumë të rëndësishëm për sistemin.

Gjatë implementimit të strategjisë së kaluar Këshilli Prokurorial ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit me organizata të shoqërisë civile si dhe gjatë kësaj periudhe ka dhënë përgjigje në kërkesa të shoqërive civile dhe mediave. Megjithatë, sistemi prokurorial ka synin vazhdimin e avancimit të bashkëpunimit me mediat, shoqërinë civile dhe organizatat e tjera, si dhe ngritjen e profesionalizimit në komunikimin e jashtëm, të genit me afër qytetarëve, marrjen e këshillave, mendimeve dhe rekomandimeve profesionale.

Ky objektivi ka një rol jetik, sidomos në ngritjen e vetëdijes qytetare për rolin e një sistemi të paanshëm, profesional dhe me integritet profesional. Roli i shoqërisë civile, si transmetuese, por edhe duke pasur parasysh ekspertizën profesionale që mund të ofrohet në ngritjen e kapaciteteve të sistemit prokurorial është i rëndësishëm në drejtim të zbatimit të kësaj strategjie.

Megenëse, mediat dhe shoqëria civile janë partnerët tonë kryesorë në përpjekjet për përmirësimin e perceptimit të publikut dhe për qasje të qytetarët, gjendja aktuale e raportimit të gëshëve që ndërliqhen me sistemin prokurorial në Kosovë dhe niveli i bashkëpunimit me media dhe shoqërinë civile domosdoshmërisht na shtynë drejt përpjekjeve të vazhdueshme për avancimin e bashkëpunimit.

Ky objektivi synohet të përmbushet përmes aktiviteteve të parapara, si:

- ❖ Organizimi i forumeve të brendshme, ndërinstitucionale, me mediat dhe shoqërinë civile;
- ❖ Shkëmbimit të përvojave me institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
- ❖ Hulumtimeve të përbashkëta me interes për sistemin prokurorial
- ❖ Lidhjeve të akteve të bashkëpunimit dhe
- ❖ Monitorimi i rregullt i mediave, analizimi i te gjeturave të tyre si dhe nxjerrja e rekomandimeve për gëshje me interes. Ky monitorim do të zhvillohet përmes krijimit të një platformë, i cili përmban shkrimet që i referohen sistemit prokurorial.

## **VLERËSIMI DHE MONITORIMI**

Zbatimi i kësaj strategjie do të nënshtrohet një procesi të vazhdueshëm analize dhe vlerësimi, i kryer nga një grup monitorues. Ky grup monitorues do të themelohet nga Zyra për Komunikim në ZKPSH në bashkëpunim me Sekretariatit e KPK-së dhe do të ketë përgjegjësi për analizimin e implementimit të strategjisë çdo 6 muaj.

Kjo përfshin mbledhjen e informacionit, vlerësimin e rezultateve dhe identifikimin e sfidave në zbatimin e strategjisë. Grupi monitorues do të ketë rol të rëndësishëm në sigurimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë në ndjekjen e procesit të zbatimit të strategjisë së komunikimit të sistemit prokurorial të Kosovës. Përmes këtij mekanizmi të rregullt, i cili do të bëjë vlerësimin çdo gjashtë (6) muaj dhe të njëjtin do ta publikoj, do të sigurohet një përpjekje e vazhdueshme për përmirësim dhe adaptim të strategjisë sipas zhvillimeve aktuale dhe nevojave të sistemit prokurorial. Këto vlerësime do të diskutohen me partneret, mediat dhe shoqërinë civile duke kontribuar kështu në Objektivat e kësaj strategjie.

## PLANI I VEPRIMIT

### PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË SË KOMUNIKIMIT TË SISTEMIT PROKURORIAL TË KOSOVËS 2024/2026

| Aktivitetet | Indikatorët e matës | Institucioni përgjegjës | Institucionet përkrahëse | Afati kohor për realizim | Aktivitetet | Indikatorët e matës |
|-------------|---------------------|-------------------------|--------------------------|--------------------------|-------------|---------------------|
|             |                     |                         |                          |                          |             |                     |

### 1. NGRITJA E TRANSPARENÇËS DHE KOMUNIKIMI PROAKTIV NË SISTEMIN PROKURORIAL TË KOSOVËS

#### 1.1.NGRITJA E TRANSPARENÇËS PËRMES PUBLIKIMEVE TË VAZHDIESHME

| Aktivitetet   | Indikatorët e matës    | Institucioni përgjegjës                       | Institucionet përkrahëse | Afati kohor për realizim | Aktivitetet | Indikatorët e matës           |
|---|------------------------|---|--------------------------|--------------------------|-------------|-------------------------------|
| 1.1.1 Publikimi i raportit 24-orësh, përfshirë publikimin | Publikimi i përditshëm | Prokuroritë Themelore dhe Prokuroria Speciale | N/A                      | Në vazhdimësi            |             | Mbledhja në kohë e materialit |

|   |  |   |           |                    |             |  |  |
|---|--|---|-----------|--------------------|-------------|--|--|
| në rrjete sociale   |  |   |           |                    |             |  |  |
| 1.1.2 Publikimi i buletineve të sisternit prokurorial   | Dymbëdhjetë buletine, të botuara nga Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit  | Këshilli Prokurorial i Kosovës, Prokurori i Shtetit | N/A       | Çdo muaj           | I buxhetuar | Mbledhja në kohë e materialeve për hartimin e tyre.                                  |  |
| 1.1.3. Realizimi i fushatave vetëdijesuese për rolin, misionin dhe veprimtarinë e sisternit prokurorial (se paku tri fushata tematike ) | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i fushatave të realizuara.</li> <li>• Aktivitete për kategoritë e pafavorizuar a shoqërore.</li> <li>• Publikimi i materialeve televizive.</li> </ul> | Këshilli Prokurorial i Kosovës, Prokurori i Shtetit | Donatorët | Së paku tre në vit | Donatorët   | Gjetja e donatorëve. Përdorimi i kanaleve të komunikimit për komunitetet jo shumicë. |  |



|  |  |  |                      |               |             |                 |
|--|--|--|----------------------|---------------|-------------|-----------------|
|  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Publikimi i broshurave dhe materialeve të tjera informuese.</li> <li>• Promovimi i pjesëmarrjes së gjetarëve në parandalimin e veprave penale.</li> <li>• Organizimi i konferencave tematike për komunitet jo shumicë.</li> </ul> |  |                      |               | I buxhetuar | Kushtet teknike |
| 1.1.4. Organizimi i konferencave për media | Konferenca të mbajtura gjatë vitit, sipas nevojës  | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit | Partnerët mbështetës | Sipas nevojës | I buxhetuar | Kushtet teknike |

|   |                              |  |                      |               |             |   |
|---|------------------------------|--|----------------------|---------------|-------------|---|
| 1.1.5 Rritje e paraqitjeve në media nga udhëheqësit e sistemit prokurorial          | Rritje e paraqitjeve mediale | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit | Mediat               | Sipas nevojës | N/A         | KPK dhe PSH të jenë më prezentë në mediet duke kontribuar në transparencë dhe rritje të besueshmërisë tek qytetarët. Pjesëmarrje në emisione televizive, intervista etj |
| 1.1.6. Mbatja e takimeve me qytetarë  | Numri i qytetarëve           | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit | N/A                  | Në vazhdimësi | N/A         |   |
| 1.1.7. Lancimi, promovimi dhe mirëmbajtja e ueb fages së ri të sistemit prokurorial | Përditësimi i rregullt       | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit | Partnerët mbështetës | Shkurt        | I buxhetuar | Profilizimi i Kuadrove / Raportet e publikuara të jenë digjitale dhe jo të skanuara. Të ofrohen informata në gjuhët e komunitetit jo shunnicë!                          |

|  |  |  |                                       |                |             |  |
|--|--|--|---------------------------------------|----------------|-------------|--|
| 1.1.8. Avancimi i i publikimeve si nga përmbajtja po ashtu edhe nga ana vizuale. | Rritja e numrit të publikimeve<br>Avancimi cilësor i publikimeve | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit |                                       | Në vazhdim ësi | I buxhetuar | Sigurimi i të Dhënave. Materialet e ofruara të jenë vizuelisht më atraktive  |
| 1.1.9 Vetëdijësimi mbi të drejtën në gasje në dokumente publike                  | Trajnime për statin dhe mediat                                   | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit | Partnerët Mbështetës, mediat, OSHC-të | Në vazhdim ësi |             | Trajnim me redaktore dhe gazetarët e profilizuar për definimin e çështjes se gjasës në dokumente publike - përfshi afatet kohore |

## 1.2. KOMUNIKIMI PROAKTIV

| Aktivitetet  | Indikatorët e matës            | Institucioni përgjegjës                                | Institucionet përkrahëse | Afati kohor për realizim | Aktivitetet        | Indikatorët e matës  |
|--|--------------------------------|--|--------------------------|--------------------------|--------------------|--|
| 1.2.1. Ngritja e kapaciteteve të komunikimit brenda sistemit prokurorial | Trajnime, punëtori. iniciativa | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit | Donatorët                | Në vazhdim ësi           | Kërkohet përkrahje | Trajnime të vazhdueshme mbi rëndësinë e komunikimit efikas tek stafi |

|  |  |  |               |                |     |   |                             |
|--|--|--|---------------|----------------|-----|---|-----------------------------|
|  |  |  |               |                |     |   | brenda sistemit prokurorial |
| 1.2.2 Veprimi dhe reagimi në kohë  | Efikasiteti dhe efektiviteti i realizuar në komunikimin e jashtëm                | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit | Partnerët     | Në vazhdim ësi | N/A | Komunikim efikas, transparent dhe në kohë.  |                             |
| 1.2.3. Unifikimi i standardeve të komunikimit në sistemin prokurorial                                | Veprimet e ndërmarra për unifikimin e komunikimit                                | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit | Partnerët/PSH | Në vazhdim ësi | N/A | Krijimi i dokumenteve të unifikuara për komunikim me jashtë. Definimi i komunikimit të brendshëm dhe përgjegjësi të Zyrarëve për Komunikim. |                             |
| 1.2.4 Avancimi i informimit të rregullt të kryeprokurorëve dhe prokurorëve lidhur me ngjarjet ditore | Fuqizimi i monitorimit të mediave, përfshirë përditësimin mbi ngjarjet relevante | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit | N/A           | Në vazhdim ësi | N/A |   |                             |

|  |   |  |                                     |                |   |                              |  |
|--|---|--|-------------------------------------|----------------|---|------------------------------|--|
| për fushë veprimtarinë e sistemit prokurorial  |   |  |                                     |                |   |                              |  |
| 1.2.5. Komunikimi efikas dhe efektiv në raste specifike                              | Bashkëpunimi i realizuar në raste specifike                   | Këshilli Prokurorial i Kosovës, Prokurori i Shtetit dhe institucionet e tjera        | Partnerët                           | Në vazhdim ësi | N/A   | Realizimi i bashkëpunimit    |  |
| 1.2.8. Komunikimi përmes rrjeteve sociale  | Komunikimi i rregullt dhe përditësimi përmes rrjeteve sociale | Sistemi prokurorial  | N/A                                 | vazhdimësi     | Buxhetuar   | Menaxhimi i rrjeteve sociale |  |
| 1.2.9 Hartimi i udhëzuesve në fushën e komunikimit dhe përdorimit të mediave sociale | Numri i udhëzuesve të hartuar                                 | Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit dhe partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë | Partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë | Në vazhdimësi  | Të buxhetuara si dhe pritshmëri të përkrahjes nga donatorët |                              |  |

|   |         |                     |     |               |     |  |
|---|---------|---------------------|-----|---------------|-----|--|
| 1.2.10 Takime vjetore mes gazetareve dhe Prokurorit Koordinator për rastet e gazetareve | Takimet | Prokurori i Shtetit | N/A | Në vazhdimësi | N/A |  |
|---|---------|---------------------|-----|---------------|-----|--|

### 1.3 KOORDINIMI NDËRINSTITUCIONAL NË FUSHËN E KOMUNIKIMIT

| Aktivitetet  | Indikatorët e matës                         | Institucioni përgjegjës   | Institucionet përkrahëse                 | Afati kohor për realizim | Aktivitetet | Indikatorët e matës               |
|--|---|---|--|--------------------------|-------------|-----------------------------------|
| 1.3.1. Mbatja e takimeve me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera                           | Policia, gjykatat dhe institucionet e tjera | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit  | N/A                                      | Në vazhdimësi            | N/A         |                                   |
| 1.3.2. Formimi i ekipit të përbashkët (të sigurisë dhe drejtësisë) për komunikim ndërinstitucional | Ekipi ndërinstitucional                     | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit dhe institucionet e tjera zbatuese të ligjit | Partnerët                                | Sipas nevojës            | N/A         | Koordinimi me kohë i aktiviteteve |
| 1.3.3. Lidhja e memorandumëve me institucionet e tjera dhe partnerët                               | Numri i memorandumëve të lidhura            | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit,   | Institucionet e tjera zbatuese të ligjit | Në vazhdimësi            | N/A         |                                   |

|  |  |  |   |                |             |  |  |
|--|--|--|---|----------------|-------------|--|--|
|  |  | institucionet e tjera zbatuese të ligjit dhe partnerët |   |                |             |  |  |
| 1.3.4. Mbatja e konferencave të përbashkëta me Policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera zbatuese të ligjit | Konferenca të organizuara  | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit | Policia e Kosovës dhe institucionet e tjera zbatuese të ligjit    | Në vazhdim ësi | E buxhetuar | Koordinimi                               |  |
| 1.3.5. Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve me institucionet zbatuese të ligjit                            | Numri i trajnimeve të mbajtura   | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit | Institucionet e tjera zbatuese të ligjit dhe partnerët mbështetës | Në vazhdim ësi | Donatorët   | Gjetja e fondeve dhe donatorëve          |  |
| 1.3.6. Avancimi i pozitës së zyrtarit të komunikimit në nivele menaxherial / Rritja e resurseve                | Shtimi i kapaciteteve të reja të resurseve humane dhe pajisjeve teknike në zyrat e komunikimit | Këshilli i Prokurorial i Kosovës                       | N/A   | Në vazhdimësi  | N/A         | Limitet buxhetore për shtim të resurseve |  |

## 2. FUQIZIMI I KOMUNIKIMIT TË BRENDSHËM

## 2.1. KOORDINIMI I KOMUNIKIMIT TË BRENDSHËM MES NJËSIVE PËR KOMUNIKIM

| Aktivitetet   | Indikatorët e matës   | Institucioni përgjegjës | Institucionet përkrahëse | Afati kohor për realizim | Aktivitetet | Indikatorët e matës  |
|---|-----------------------|-------------------------|--------------------------|--------------------------|-------------|--|
| 2.1.1 Takime të rregullta mujore mes zyrtareve për komunikim të sistemit prokurorial për gëshhtë koordinimi | Numri i takimeve      | Prokurori i Shtetit     | N/A                      | Mujore                   | N/A         |  |
| 2.1.2 Takime mes zëdhënësve të sistemit prokurorial dhe kryeprokurorëve për gëshhtë koordinimi              | 1takim në vit së paku | Prokurori i Shtetit     | N/A                      | Në vazhdimëve            | N/A         |  |
| 2.1.3 Krijimi i kalendarëve të përbashkët brenda sistemit për   | Krijimi i kalendarit  | Prokurori i Shtetit     | N/A                      | Në vazhdimësi            | N/A         | Të gjitha zyret e komunikimit përtshijnë aktivitetet e tyre në |



|  |   |   |            |             |  |
|--|---|---|------------|-------------|--|
| <p>aktivitetet komunikuese</p>                                     |   |   |            |             | <p>kalendar duke kontribuar në koordinim të aktiviteteve</p> |
| <p>2.1.4 Përmirësimi i Proceeseve të Komunikimit të Brendshëm:</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i proceseve aktuale të komunikimit dhe identifikimi i mundësive për përmirësimin dhe efikasitet.</li> <li>Përfshirja e punonjësve në këtë proces për të siguruar ndërgjegjësimin dhe përkrahjen e tyre.</li> </ul> | <p>Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit</p> | <p>N/A</p> | <p>2024</p> | <p>N/A</p>   |

## 2.2. KOORDINIMI I KOMUNIKIMIT TË BRENDSHËM TË NJËSIVE PËR KOMUNIKIM ME NJËSITË E TJERA

### ORGANIZATIVE

| Aktivitetet   | Indikatorët e matës                       | Institucioni përgjegjës  | Institucionet përkrahëse | Afati kohor për realizim | Aktivitetet | Indikatorët e matës |
|---|---|--|--------------------------|--------------------------|-------------|---------------------|
| 2.2.1. Koordinimi i komunikimit ndërmjet njësive të KPK-së                                      | Efikasiteti dhe intensiteti i komunikimit | Këshilli Prokurorial i Kosovës                                     |                          | Në vazhdim ësi           |             |                     |
| 2.2.2. Koordinimi i komunikimit ndërmjet njësive të ZKPSH-së                                    | Efikasiteti dhe intensiteti i komunikimit | Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit                                   |                          | Në vazhdim ësi           |             |                     |
| 2.2.3. Koordinimi i komunikimit ndërmjet njësive të prokurorive                                 | Efikasiteti dhe intensiteti i komunikimit | Prokuroria e Apelit, Prokuroria Speciale dhe prokuroritë themelore |                          | Në vazhdim ësi           |             |                     |
| 2.2.4. Koordinimi i komunikimit ndërmjet të gjitha njësive organizative të sistemit prokurorial | Efikasiteti dhe intensiteti i komunikimit | Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit                       |                          | Në vazhdim ësi           |             |                     |

### 3. AVANCIIMI I BASHKËPUNIMIT ME MEDIA, SHOQËRINË CIVILE DHE ORGANIZATA TË TJERA

| Aktivitetet   | Indikatorët e matës   | Institucioni përgjegjës  | Institucionet përkrahëse            | Afati kohor për realizim   | Aktivitetet | Indikatorët e matës               |
|---|---|--|-------------------------------------|--|-------------|-----------------------------------|
| 3.1. Organizimi i forumeve të brendshme, ndërinstitutionale, me mediat dhe shoqërinë civile | Numri i forumeve të organizuara   | Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit                         | Mediat, OSHC                        | Min. një 1 gjate vitit   | Donatorët   | Financimi dhe gjëfta e donatoreve |
| 3.2. Shkëmbimi i përvojave me institucionet vendore dhe ndërkombëtare                       | Takimet e mbajtura, vizitat e realizuara studimore dhe praktikat e realizuara | Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit dhe institucionet tjera | Partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë | Në vazhdimësi  | Donatorët   |                                   |
| 3.3. Hulumtimet e përbashkëta me interes për sistemin prokurorial                           | Hulumtimet e përbashkëta  | Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit                         | Mekanizmat jashinstitutional        | Min. Një (1) here ne vit për matjen e knaqshme rise se gytetarëve me | Donatorët   | Buxheti, gjëfta e donatoreve      |

|   |  |  |  |               |                             |                                     |  |
|---|--|--|--|---------------|-----------------------------|-------------------------------------|--|
|   |  |  |  |               | sistemin<br>prokurori<br>al |                                     |  |
| 3.4. Lidhja e akteve të bashkëpunimit   | Aktet e nënshkruara  | Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit | Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit | Në vazhdimësi | Donatorët                   | Realizimi i akteve të bashkëpunimit |  |
| 3.5. Monitorimi i rregullt i mediave, analizimi tyre si dhe nxjerrja e rekomandimeve për gëshhtë me interes | Numri i rasteve të iniciuara ne baze te monitorimit te mediave | KPK, PSH                                     | Mediat                                       | Në vazhdimësi |                             |                                     |  |

Valbona



**Valbona Beqa**

Administration/Protocol Officer - Office of the Head of Mission  
European Union Rule of Law Mission in Kosovo

Email: [valbona.beqa@eulex-kosovo.eu](mailto:valbona.beqa@eulex-kosovo.eu)

Tel: +383 38 78 4026

Mob: +383 49 78 4026

P.O. Box 268, 10000 Pristina, Kosovo



**KUJDES: E-MAIL I JASHTËM!**

Ky e-mail ka burim jashtë sistemit të postës elektronike zyrtare të Institucioneve të Kosovës. Mos klikoni në linqe nëse ato nuk janë të njohura për juve. Nëse mendoni që email-i është i dyshimt, ju lutem kontaktoni CERT Qeveritar 30900 ose email [Ashi.Cert@rks-gov.net](mailto:Ashi.Cert@rks-gov.net)

**PAŽNJA: SPOLJNI E-MAIL!**

Ovaj e-mail ima izvor izvan zvaničnog sistema elektronske pošte kosovskih institucija. Ne klikajte na linkove ako vam nisu poznati. Ako mislite da je imejl sumnjiv, kontaktirajte državni CERT 30900 ili pošaljite email na [Ashi.Cert@rks-gov.net](mailto:Ashi.Cert@rks-gov.net).

**KUJDES: E-MAIL I JASHTËM!**

Ky e-mail ka burim jashtë sistemit të postës elektronike zyrtare të Institucioneve të Kosovës. Mos klikoni në linqe nëse ato nuk janë të njohura për juve. Nëse mendoni që email-i është i dyshimt, ju lutem kontaktoni CERT Qeveritar 30900 ose email [Ashi.Cert@rks-gov.net](mailto:Ashi.Cert@rks-gov.net)

**PAŽNJA: SPOLJNI E-MAIL!**

Ovaj e-mail ima izvor izvan zvaničnog sistema elektronske pošte kosovskih institucija. Ne klikajte na linkove ako vam nisu poznati. Ako mislite da je imejl sumnjiv, kontaktirajte državni CERT 30900 ili pošaljite email na [Ashi.Cert@rks-gov.net](mailto:Ashi.Cert@rks-gov.net).